



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:088992

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05765528

KPPP.nr.463/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Medo-Flor” D.O.O, me NRB: 0606154 me seli në Republikën e Kroacisë, të cilën e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.p.k – Prishtinë, kundër debitorit N.T.P “Medo Flor” me NRB: 2016465, me seli në Magjistralen Prishtinë Shkup – Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor E.nr 1682/13 e datës 30.12.2013 lidhja P.nr.121/18 të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.P “Medo Flor”, ANULOHET Urdhri Përmbartimor E.nr 1682/13 e datës 30.12.2013 të lëshuar nga Gjykata Themelore Prishtinë, lidhja P.nr. 121/2018, i Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Medo-Flor” D.O.O, ka caktuar Urdhrit Përmbartimor me numër E.nr 1682/13 të datës 30.12.2013 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Fatura nr. 1 me dt.24.01.2012, nr.2 me dt. 31.01.2012, nr.3 me dt.29.02.2012, nr. 4 me dt. 29.02.2012, nr. 5 me dt. 23.04.2012, nr.7 me dt. 20.08.2012, nr.8 me dt. 28.10.2011, nr. 9 me dt.22.11.2011, në bazë të cilave detyrohet debitori që kreditorit në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi t’ia paguaj borxhin e mbetur në shumën prej 102.473,07 € me

kamatë ligjore prej arritjes së pagesave të faturave e deri në pagesën definitive, me shpenzimet e procedurës përbaruese.

Gjykata Themelore në Prishtinë sipas Aktvendimit E.nr.1682/13 ka caktuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit ndaj debitorit, ndërsa sipas konkluzionit të Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër Cp.nr.284/16 të datës 07.02.2018, këtë çështje përbarimore sipas zgjedhjes së kreditorit i dorëzon për procedim të mëtejme përbaruesit privat Ilir Mulhaxha dhe e cila lëndë merr numrin P.nr.121/2018.

Debitori urdhrin për lejimin e përbarimit e ka pranuar më datën 12.05.2014, ndërsa ndaj urdhrin për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor me datën 16.05.2014 debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ndër të tjera ka deklaruar se Aktvendimi është i pabazuar në prova të tërësishme. Tutje thekson se gjatë vitit 2012 ka filluar të bie shitja e produkteve të kreditorit të cilat i shiste debitori në tregun kosovar, kështu që u morën vesh që të lëshojnë produkte në treg në formë reklamimi pa pagesë, mirëpo për këtë veprim kreditori dhe e faturoi debitorin për sasi të produkteve të plasuar për qëllime marketingu dhe kërkoi nga debitori që t'u kërkonte paratë kompanive që i ka furnizuar por kërkesa që të paguhen ishte e pasuksesshme ngase iu ishte dhënë klientëve për qëllime marketingu. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës që Aktvendimi i ankimuar të shfuqizohet dhe lënda të përcillet në procedurë të rregullt gjyqësore,

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor.

Gjykata në ri procedurë duke i pasur parasysh sugjerimet dhe vërejtjet Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë sipas vendimit K.DH.SH.II.nr.1093/23 të datës 06.03.2024, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet dhe procedura përbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura me nr.1 me dt.24.01.2012, nr.2 me dt. 31.01.2012, nr.3 me dt.29.02.2012, nr.4 me dt. 29.02.2012, nr.5 me dt. 23.04.2012, nr.7 me dt.

20.08.2012, nr.8 me dt. 28.10.2011, nr.9 me dt.22.11.2011, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet - faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat në rastin konkret nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjta të jetë pranuar në ndonjë formë tjetër nga debitori.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim lidhur me zhvillimin e afarizmit mes të palëve, dhe erdhi në përfundim se pretendime të tillë janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësime tjera, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarrimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 29, 37 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet e besueshme, mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi, nuk kanë tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe

nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.463/24, datë 30.05.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.